



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1169 Prot.

Tiranë, më 15.08.2022

VENDIM
Nr. 39, datë 15.08.2022
PËR

**VIJIMIN E REGJISTRIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË FSHL DHE FVFR PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, Nr.8, datë 30.06.2022 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2022-2023”, si dhe në Vendimin e Rektoratit nr.35 datë 22.07.2022 “Për miratimin e procedurave të pranimit të studentëve të ciklit të parë në programet e studimeve “Shkencat e Lëvizjes” dhe “Fushat e Veprimtarisë, të Shëndetit dhe Rekreacionit” për vitin akademik 2022-2023”, Rektorati në mbledhjen e datës 22.07.2022

VENDOSI:

1. Të planifikojë për periudhën e regjistrimeve të aplikantëve për të ndjekur studimet në programet e Ciklit të Parë Bachelor pranë FSHL dhe FVFR, ndryshimin e Pikës 2 të Vendimit të Rektoratit nr.35 datë 22.07.2022 si më poshtë vijon:
Datat e regjistrimeve për konkurset e pranimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës janë:
✓ Për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes për programin e studimit Cikli I-rë Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes”, regjistrimi do të jetë i hapur për të gjithë kandidatët aplikantë nga data 16.08.2022, deri në orën 12:00 të datës 19.08.2022. Menjëherë pas mbylljes së regjistrimit, shpallet lista e kandidatëve dhe konkurimi do të zhvillohet po në datën 19.08.2022 (organizuar në baterinë e fundit).
✓ Për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit për programin e studimit Cikli I-rë Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit”, regjistrimi do të jetë i hapur për të gjithë kandidatët aplikantë nga data 16.08.2022, deri në orën 12:00 të datës 23.08.2022. Menjëherë pas mbylljes së regjistrimit, shpallet lista e kandidatëve dhe konkurimi do të zhvillohet po në datën 23.08.2022 (organizuar në baterinë e fundit).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi dhe marrjen e të gjitha masave për zhvillimin e procedurave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, Administratori i UST-së, Zv/Rektorët, Dekanatet e Fakulteteve, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë Publikun dhe Studentët.
3. Ky Vendim publikohet në faqen zyrtare të UST-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. AGRON KASA

